

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC – 09 – 0100

Në padinë e

[REDACTED]

Paditësja/Ankuesja

Rruga [REDACTED] Prishtinë
përfaqësuar nga [REDACTED]
Avokat nga Prishtina, rruga [REDACTED]

kundër

1. [REDACTED]

Të Paditurit

Rruga [REDACTED] Prishtinë

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr. 8,
10 000 Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, lidhur me ankesën e Paditëses/Ankueses kudër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 12 nëntor 2009, SCC – 09 – 0136, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 3 qershor 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

- 1. Ankesa është e bazuar.**
- 2. Aktvendimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së i datës 12 nëntor 2009 në lëndën me numër SCC-09-0136 lihet mënjanë dhe lënda i kthehet Trupit Gjykues të DHPGJS-së për rigjykim.**

- 3. Ankuesi fillimisht obligohet që t'i paguajë tarifat gjyqësore në shumën prej 60 eurove për procedurën ankimore pranë Dhomës së Posaçme.**
- 4. Trupi Gjykues do të duhet të vendosë mbi caktimin e shpenzimeve të procedurës ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 21 korrik 2009, Paditësja parashtrroi një padi me anë së cilës i kërkoi Trupit Gjykues të DHPGJS-së ta obligojë të Paditurin e parë ta paguajë "borxhin e qirasë për ndërtesën ku Paditësja ka qenë duke punuar", "shumën dhe datën e cila do të përcaktohet në seancën e shqyrimit kryesor". Veç kësaj, Paditësja i kërkoi të Paditurit të parë të jetë i obliguar ta paguajë interesin ligjor për shumën e pretenduar të parave dhe që i Padituri i parë t'i rimbursojë të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Sipas padisë, Paditësja është punëtore e të Paditurit të parë dhe se ka qenë duke punuar në postë "kontabiliste e të ardhurave personale". Pas luftës, i Padituri i parë kishte lidhur një marrëveshje për qira dhe kishte kryer punët e tjera. Që nga viti 1999, punëtorët e të Paditurit të parë kanë marrë mujore si pjesë e pagesave të qirasë dhe ende janë duke marrë pagesa nga të ardhurat e të Paditurit të parë. Paditësja pohon se ajo ende ka të drejtë të marrë pagesën e njëjtë mujore si punëtorët e tjerë të Paditurin të parë.

Me urdhrin e datës 14 tetor 2009, Trupi Gjykues i ka kërkuar Paditëses që brenda 14 ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri të parashtrøjë: 1.) "adresën e Paditëses dhe adresën për dërgim të të Paditurit"; 2.) "argumentet ligjore mbi të cilat bazohet padia, së bashku me përkthimet e tyre në gjuhën angleze"; 3.) "detajet e shumës së zgjidhjes së kërkuar dhe sqarimin se nga kush kërkohet zgjidhja"; 4.) "bazën sipas së cilës Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me AKM-në ka juridikSION lidhur me padinë"; 5.) "dëshminë e njoftimit me shkrim të qëllimit të Paditëses për ta ushtruar padinë kundër Ndërmarrjes tek agjencia brenda periudhës së përcaktuar së bashku me përkthimin në gjuhën angleze" në pajtim me Nenin 29.1 dhe 30.2 të Rregullores (RREG) së UNMIK-ut 2002/12. Më 27 tetor 2009, brenda periudhës së

përcaktuar kohore, Paditësja u përgjigj në urdhrin e Trupit Gjykues duke dorëzuar adresën e saj dhe adresën për dërgim të të Paditurit. Ajo gjithashtu theksoi se marrëdhënia e saj me të Paditurin e parë është e bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punësimit, duke qenë kushti i saj si ish punëtore e bankës që as nuk është kontestuar kurrë, por as edhe nga vetë i Padituri. Paditësja gjithashtu ka theksuar se Bordi Drejtues i tanishëm i bankës, i cili e mori drejtimin pas luftës, që nga viti 1999 është duke dhënë me qira lokalet për organizatat dhe kompanitë e ndryshme ndërkontinentare dhe atë duke i ndarë të ardhurat me ish punëtorët e bankës, përveç me atë. Megjithatë, ajo nuk është në gjendje të ofrojë detaje për shumën e parave të mbledhura dhe të ndara, pasi që asaj kurrë nuk i është mundësuar qasja tek Bordi Drejtues.

Për sa i përket juridiksonit të DHPGJS-së, Paditësja theksoi se e Paditura është një ndërmarrje shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, dhe se kjo vërtetohet me faktin se ajo fillimisht ushtroi padinë pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës (lënda C 1332/07), e cila e kishte dekluaruar vetën jokompetente ta gjykojë lëndën dhe e këshilloi Paditësen ta parashtrojë padinë në DHPGJS.

Në fund, duke u përgjigjur në pyetjen e njoftimit të Agjencisë, Paditësja nënvizon se Agjencia ishte në dijeni për padinë, madje duke qenë e pranishme në një seancë dëgjimore në Gjykatën Komunale dhe gjatë së cilës përfaqësuesi i Agjencisë e ngriti çështjen e juridiksonit duke çuar në vendimin e Gjykatës Komunale lidhur me mos kompetencën e saj. Paditësja bashkëngjiti kopjen e procesverbalit të seancës dëgjimore të mbajtur në Gjykatën Komunale më datën 19 qershor 2009.

Më 12 nëntor 2009, Trupi Gjykues i DHPGJS-së e refuzoi padinë mbi bazat e papranueshmërisë. Sipas arsyetimit ligjor të aktvendimit, Paditësja e parashtri sqarimin e kërkuar sipas urdhrit të DHPGJS-së së datës 14 tetor 2009, megjithatë jo të kompletuar. Paditësja nuk e ceku shumën e zgjidhjes së kërkuar siç kërkohet nga Neni 27.2 (d) i Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 dhe nuk i dërgoi Agjencisë, "e zbatuar sipas analogjisë për të Paditurin e dytë, me njoftimin me shkrim të qëllimit të saj për ta parashtruar padinë kundër Ndërmarrjes gjashtëdhjetë (60) ditë para parashtrimit të tanishëm të padisë, siç

kërkohet nga Neni 28.2 (e) i UA i UNMIK-ut 2008/6 dhe Nenet 29.1 dhe 30.2 të RREG së UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar. Njoftimi me shkrim për të Paditurin e dytë duke e njoftuar atë për qëllimin e saj për fillimin e një padie kundër ndërmarrjes dhe të Paditurit të dytë është i datës 23 tetor 2009, i ushtruar pas parashtrimit të padisë së tanishme më 21 korrik 2009 dhe kjo e bërë jo me kohë".

Me ankesën, e parashtruar me kohë nga Paditësja (tash e tutje Ankuesja), Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme i kërkohet ta lë mënjanë aktvendimin e Trupit Gjykues dhe ta kthejë lëndën për rigjykim. Ankuesi thekson se me përgjigjen e saj të datës 27 tetor 2009 ndaj urdhrit të Dhomës së Posaçme ajo i ka plotësuar të gjitha kërkesat. Në veçanti, ajo nënvízoi se për atë nuk ka qenë e mundur ta dijë shumën e zgjidhjes së kërkuar sepse ajo kurrë nuk ka qenë në gjendje të lidhte kontratë me Bordin Drejtues të bankës; prandaj ajo nuk është në dijeni lidhur me shumën e të ardhurave të mbledhura deri më tanë nga viti 1999, dhe shumën që ishte ndarë në mes të punëtorëve të tjerë. Për këtë arsyе Ankuesja në padinë e saj ka kërkuar një ekspertizë për të llogaritur një shumë të tillë, në pajtim me Nenin 36 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Sa i përket njoftimit të Agjencisë, Ankuesi thekson se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ishte e njoftuar ashtu siç duhet lidhur me padinë, pasi që përfaqësuesi i saj ishte i pranishëm, siç del nga procesverbali, në seancën dëgjimore pranë Gjykatës Komunale më 2 korrik 2009, dhe duket qartë nga ato procesverbale se Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka kërkuar Gjykatës Komunale ta deklarojë vetën si jokompetente për shkak të mungesës së juridikzionit, dhe ta këshillojë Paditësen ta parashtrojë një padi të re pranë Dhomës së Posaçme.

Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka parashtruar mbrojtjen e saj me kohë, gjithashtu në emër të të Paditurit të parë, me anë të së cilës AKP-ja kërkon të refuzohet ankesa e Ankueses duke u bazuar në atë se ajo nuk kishte dorëzuar asnje fakt të ri ose dëshmi që do të çonin në anulimin e aktvendimit të Trupit Gjykues. Ajo nuk e ka cekur shumën e këstít mujor të cilin ajo e pretendon si ish punëtore e bankës.

Arsyetimi ligjor:

Zgjidhja e kérkuar nga Paditësi

Neni 27.2 (d) i UA i UNMIK-ut 2008/6 kérkon që padia në mënyrë që të sillet pranë Dhomës së Posaqme duhet të theksojë (...) zgjidhjen e kérkuar nga Paditësi. Neni 28.2 (f) i UA-së thekson se padia është e pranueshme vetëm nëse (...) "parashtresat janë paraqitur [...] në përputhje me kushtet nga Nenet 25 dhe 27 të kësaj Urdhërese Administrative".

Neni 27.2 (d) i UA i UNMIK-ut 2008/6, sipas formulimit të tij nuk kérkon një tregues të *shumës* së një zgjidhjeje të tillë.

Neni 70.3 (a) i UA i UNMIK-ut 2008/6 nënvizon se gjatë interpretimit të kësaj UA-je, ose për ndonjë çështje e cila, sipas gjykimit të saj, nuk është zgjidhur në mënyrë të duhur sipas kësaj UA-je, DHPGJS-ja mund të marrë parasysh, me ndryshimet dhe kufizimet që i konsideron të domosdoshme ose të përshtatshme në ato rrethana, për cilëndo dispozitë të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që zbatohet në Kosovë. Sipas Nenit 253 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës (tash e tutje NLCP, Ligji Nr. 03/L-006), padia përbëhet nga një kérkesë e caktuar në pajtim me çështjen kryesore dhe qasjen e kérkesave, provave sipas së cilave Paditësi e ka bazuar padinë, provën që i vërteton faktet, vlerën e kontestit dhe bazën juridike dhe të dhënat e tjera që duhet të jenë pjesë e secilës parashtresë (Neni 99). Në të kundërtën, Neni 186 i ligjit në fuqi të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (tash e tutje LPK-ja, Gazeta Zyrtare e SFRJ-së 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596) përcakton që padia duhet të ketë një padi specifike duke theksuar çështjen parësore dhe paditë e varura, faktet mbi të cilat Paditësi e bazon padinë e tij/saj, dëshmi për ti mbështetur ato fakte dhe të gjitha informatat e tjera që duhet ti përmbarë secila kérkesë (Neni 106). Siç është treguar, sipas LPK-së shuma e padisë nuk ka nevojë të theksohet domosdoshmërisht në padi.

Në rastin në fjalë, Paditësja ka theksuar në padi – dhe gjithashtu në përgjigje ndaj urdhrit të gjykatës – se ajo është duke kérkuar pagesën e kësteve mujore si pagë mujore, në cilësinë e saj si ish punëtore e bankës, siç është duke ndodhur

me ish punëtorët e tjerë, që nga viti 1999. Paditësja gjithashtu ka theksuar se ajo nuk është në gjendje të ofrojë ndonjë tregues për një shumë të tillë, për shkak të faktit se asaj kurrë nuk i është mundësuar të lidh kontratë me Bordin Drejtues i cili pretendohet se ishte i ngarkuar me mbledhjen dhe shpërndarjen e parave. Në anën tjetër, Paditësja është duke kërkuar që gjykata ta kryejë ekspertizën në mënyrë që ta caktojë shumën e tillë.

Sipas formulimit të Nenit 27.2 (d) të UA të UNMIK-ut 2008/6 dhe Nenit 186 të LPK-së padia është e papranueshme për shkak të arsyes se nuk e përmban shumën e zgjidhjes së kërkuar. Në rastin në fjalë, shuma e zgjidhjes së kërkuar mund të definohet vetëm bazuar në informatën se i Padituri i parë mund të posedojë dhe do të mund të obligohet të ofrojë.

Njoftimi i Agjencisë

Sipas Nenit 29.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 e lidhur me Nenin 28.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6 një njoftim me shkrim për qëllimin e parashtrimit të padisë kundër ndërmarrjes shoqërore duhet ti jepet Agjencisë (para – “qëllimit të parashtrimit të padisë”) për parashtresën e padisë. Njoftimi i Agjencisë për qëllimin e parashtrimit të padisë kundër ndërmarrjes shoqërore është njëra prej kritereve të pranueshmërisë siç është përcaktuar në Nenin 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6.

Veç kësaj, sipas Nenit 30.2 të RREG së UNMIK-ut 2002/12, DHPGJS-ja nuk do të pranojë asnë padi kundër Agjencisë, përvèç nëse Paditësi dorëzon dëshmi, se ka njoftuar Kryesuesin e Bordit, për dorëzimin e padisë së tillë së paku gjashtëdhjetë ditë, para dorëzimit aktual të saj. Si dhe njoftimi i Agjencisë për qëllimin e parashtrimit të padisë kundër Agjencisë është njëra prej kritereve të pranueshmërisë siç është përcaktuar në Nenin 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6.

Paditësja me përgjigjen ndaj urdhrit të Trupit Gjykuas dërgoi një kopje të njoftimit me shkrim tek AKP-ja më datën 23 tetor 2009, e cila është pranuar nga AKP-ja më 26 tetor 2009. Andaj kjo është bërë pas ushtrimit të padisë pranë DHPGJS-së.

Sipas ankesës dhe përgjigjes ndaj ankesës, me të njëjtën padi gjithsesi ishte marrë më parë edhe Gjykata Komunale në Prishtinë. Në Gjykatën Komunale, padia ishte hedhur poshtë si e papranueshme për shkak të mungesës së kompetencës së gjykatës. Sipas deklaratave të Paditëses, të cilat të Paditurit nuk i kanë mohuar, padia kundër të Paditurit të parë është zgjatur kundër të Paditurit të dytë, AKP-në, më 19 qershor 2009 në Gjykatën Komunale. Më tej, sipas procesverbalit të Gjykatës Komunale të seancës së shqyrimit kryesor të datës 2 korrik 2009, përfaqësuesi i të Paditurve i propozoi gjykatës që Paditësja duhet ta adresojë këtë çështje tek Dhomë e Posaçme. Më 21 korrik 2009, Paditësja ushtroi padinë pranë DHPGJS-së.

I Padituri i dytë ka qenë në dijeni për padinë e Paditëses tashmë më së voni në qershor 2009; më 2 korrik 2009 përfaqësuesi i të Paditurit të dytë e drejtoi Paditësin tek DHPGJS-ja. Sipas këtyre rr Ethanave të veçanta, nuk ka qenë e nevojshme për një njoftim me shkrim të ndarë para se të parashtrohej përsëri padia e njëjtë pranë Dhomës së Posaçme. Qëllimi i njoftimi është që ta njoftojë Agjencinë lidhur me paditë (e mundshme), dhe t'u ofrojë atyre mundësi për t'u marrë me këtë çështje, dhe nëse është e mundur për të arritur një marrëveshje miqësore për çështjen para fillimit të procedurës gjyqësore në gjykatë. Andaj ky raport i ligjit nuk kishte më ndonjë rëndësi. Në vazhdim, duhet të merret parasysh se detyra e Paditëses për ta njoftuar Agjencinë paraprakisht, dhe në raste të caktuara kundër Agjencisë 60 ditë më parë, i shtonë edhe një barrë më shumë për qasjen e saj në drejtësi dhe andaj duhet të interpretohet në mënyrën përkatëse.

Si rrjedhojë, padia nuk mund të konsiderohet si e papranueshme mbi bazat e njoftimit të paafatshëm.

Kthimi i lëndës tek Trupi Gjykues

Prandaj Trupi Gjykues e hodhi poshtë padinë si të papranueshme mbi baza të pavlefshme. Andaj Aktvendimi i kontestuar duhet të lihet mënjanë dhe të kthehet tek Trupi Gjykues për rigjykim. Sipas këtyre rr Ethanave, Kolegji i Ankesave nuk është në gjendje ti marrë parasysh bazat meritore të padisë si shkallë e parë dhe nuk mund të marr qëndrim mbi bazën ligjore të padisë.

Shpenzimet / Tarifat gjyqësore

Zbatohen shpenzimet vijuese të gjyqit për procedurën ankimore (shih ASC-09-0072):

Tarifa e Shpenzimit të Gjyqit Neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifa e Shpenzimit të Gjyqit Neni 10.15 e lidhur me 10.21 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Gjithsejtë	60 Euro

Këto shpenzime të gjyqit paraprakisht do të barten nga Ankuesi i cili si rrjedhojë obligohet t'i paguajë shumën e përmendur Dhomës së Posaçme.

Do t'i takojë Trupit Gjykues t'i caktojë këto shpenzime të procedurës ankimore në mes të palëve.

Richard Winkelhofer, Gjyqtari Kryesues i EULEX-it _____ nënshkruar_____

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it _____ nënshkruar_____

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it _____ nënshkruar_____

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it _____ nënshkruar_____ i
EULEX-it